

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Dana

17.07.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:008793

Datë: 11.06.2018

Numri i dokumentit: 00059292

P.nr.434/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren in ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2332-1/2017 dt. 20.03.2018, me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, dhe të akuzuarit pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 11.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED] nga babai [REDACTED] dhe nëna [REDACTED], të vajzërisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë i gjendjes së mesme ekonomike i pa dënuar deri me tani, mbrohet në liri me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED]. -

Ë shtë F aj t o r

Sepse me datë 27.10.2017, rreth orës 14:00 h, në rrugën "Anton Qeta", në Shtime pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotikë, në kuadër të planit operativ të policisë "Stop Droga në Shkolla", gjatë kontrollit të pandehurit, i kanë gjetur në xhepin e jaknës, në qese me substancë narkotike, ku pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka rezultuar se substance narkotike është i llojit kanabis me peshë prej 1,05 gram,- e cila është sekuestruar nga policia.

- me këtë ka kryer veprën penale **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës.**

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 / njëqind / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në dy këste mujore në afat prej dy muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallin gjyqësor të paguan shumën prej 20 Euro, si dhe taksën 30 Euro konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

III. I shqiptohet taksa në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

IV. Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së gjykata konfiskon substancën narkotike të llojit marihuana me peshë neto të përgjithshme me peshë prej 1,05 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2332-1/2017 dt. 20.03.2018, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt. 11.06.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani dhe i akuzuari [REDAKTUAR].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR], ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar ku atë ditë rreth orës 14:00, derisa kishte qenë me shokun e tij [REDAKTUAR] duke u shëtitur në rrugën "Anton Qeta" në Shtime i kishin ndaluar policia, ku gjatë kontrollimit ia kishin gjetur një qese me marihuanë, të cilën e ka blerë nga një person i pa njohur dhe e ka blerë me çmim pre 3 euro, por nga ai moment as nuk e ka përdorur,

është hera parë që ndeshet me ligjin, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqiptimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajësisë përmes vendimit për veprën e kryer.

Gjyqtari në kuptim nën paragraf 248 par.1 nën paragraf 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe paragraf 4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të paragraf 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në raportin e ekspertimit të agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. AKF/20173891/2017-3488 e datës 07.03.2018, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve e datës 27.10.2017, fotografitë provat materiale, fotografitë e të pandehurit si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha, elementet e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të akuzuarit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë nga ana e tij, ka treguar sinqeritet në procedurën penale, substancën narkotike e kanë përdorur për vetë, kanë deklaruar se tani nuk e përdorë, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre shkaqeve, i shqiptoi dënim me gjobë nga 100 / njëqind / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej dy muajsh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si në diapozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe *me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që të akuzuarit të mos kryejnë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.*


Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nën par.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 paragraf 1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.434/18 me datë 11.06.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



Numri i lëndës: 2018:008793
Datë: 11.06.2018
Numri i dokumentit: 00059292

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.